



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Rikonstruktion Salla e Leksioneve tek Godina e Paraklinikut”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punime ndërtimi- 45210000-2

VLERA E FONDIT LIMIT:

32,107,345 (tridhjetë e dy milion e njëqind e shtatë mijë e treqind e dyzet e pesë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

Formulari i ofertës sipas Shtojcës 1;

Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit sipas Shtojcës 2;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 7, gërma “ç” (sipas Shtojcës 1 dhe 2 të DST).

Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 7 të DST

Argumentimi: Ky kriter u vendos në zbatim të nenit 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim, për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit i kontratës objekt prokurimi**. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitetin financiar për të përbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare 2020, 2021, 2022, që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. Kërkesa konsiderohet e përbushur nëse në bilancet e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të

kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr. 10091 datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

2.2.3. Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale.

Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, konkretisht në vlerën 16,053,672.50 (gjashtëmbëdhjetë milion e pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy presje pesëdhjetë) lekë pa tvsh dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose,

- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, konkretisht: 62,214,690 (gjashtëdhjetë e dy milion e dyqind e katërmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë pa tvsh

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit; **(në rastet kur ky dokumentacion lëshohet)**
 - Çertifikatën e marrjes në dorëzim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Vërtetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit; **(në rastet kur ky dokumentacion lëshohet)**
 - Çertifikatën e marrjes në dorëzim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim;
 - Fatura tatimore të situacionit përfundimtar

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme/Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë të deklaruar në fazën e tenderimit;
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:
 - a) Kontratë bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe
 - b) Miratimin zyrtar si nënkontraktor nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose minimalisht sa dyfishi i fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar nenit 77, pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.

Njësia e Prokurimit argumenton se puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 2.3.1/a dhe 2.3.1/b, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Nga praktika, gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, është konstatuar se Komisionet e Vlerësimit të Ofertave kanë hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa me të drejtë të përvojës së ngjashme, në rastet kur në formularët e vlerësimit nuk përcaktohen % e pjesëmarrjes të secilit operator bashkim, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private lëshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve), për rrjedhojë është e domosdoshme që Operatorët Ekonomik kur paraqesin kontrata të ngjashme, ku janë pjesë e një

bashkimi operatorësh duhet të paraqesin gjithashtu dhe marrëveshjen e bashkëpunimit dhe prokurën e posaçme/Marrëveshje bashkëpunimi ku të përcaktohen % përkatëse.

Në kuadër të vlerësimit të përvojës së ngjashme të secilit operator ekonomik pjesëmarrës, në mënyrë sa më të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nënkontraktimit, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit, me marrëveshjen e nënkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nënkontraktimit lëshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo operator ekonomik si në rastin kur ka qenë palë në Bashkimin e operatoreve ekonomik ashtu dhe në rastet kur ka qenë Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk sjell kufizim të pjesmarrjes së operatorëve ekonomik në tender.

Të dy këto kërkesa, vendosin në kushte të barabarta dhe u japin mundësi të gjithë operatorëve ekonomik Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit dhe marrëveshjet përkatëse të nënkontraktimit nuk janë të plotësuara sipas kërkesave ligjore.

Njësia e Prokurimit ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku ndër të tjera përcaktohet se: **“Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve”**.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

NP 2 - A (Ndërtime civile dhe industriale)

NP 3 - A (Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada)

NP 12 - A (Punime të inxhinierisë së Mjedisit)

NS 1- A (Punime për prishjen e ndërtesave);

NS 2- A (Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre);

NS 4 - A (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese);

NS 8- A (Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.);

NS 12 - A (Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit) ;

NS 14 – A (Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV);

NS 18 - A (Punime topogjeodezike)

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk

korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, gjithashtu të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NP 2 - A	Ndërtime civile dhe industrial	<i>Punime Murature Punime tarrace dhe hidroizolimi Punime shtresash</i>	0-20 Vlera e parashikuar në preventiv për këtë kategori punimesh është rreth 4,507,903 lekë
NP 3 - A	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash	<i>Suva e zakonshme fasade Suvatim me grafiato Veshje fasade me alukobond Veshje strehe me gips çimentato Fasade elemente vertikale metali montuar në strukturë çeliku</i>	0-20 Vlera e parashikuar në preventiv për këtë kategori punimesh është rreth 6,988,928 lekë
NP 12 - A	Punime të inxhinierisë së Mjedisit	<i>Punime Prishje Prishje shtresa tarace Prishje dhe heqje mbulesa, vetrata, dyer, tavane gipsi etj.</i>	Kjo kategori është përfshirë pasi duke qenë se do të ketë punime prishje, evadim mbetjesh ndërtimore dhe

		<p><i>Transport i mbeturinave deri në ambjentet e jashtme.</i></p> <p><i>Transport i mbeturinave me auto deri 12 km landfilli i Sharrës</i></p>	<p>ndodhemi në një objekt arsimor brenda kompleksit spitalor Universitar “Nënë Tereza”, ndikimi në mjedis dhe përkuqjesja me marrjen e masave për ruajtjen e ambientit konsiderohet si tepër e rëndësishme</p> <p>Për referencë vlere është marrë kategoria</p> <p>0-20</p>
NS 1- A	Punime për prishjen e ndërtesave	<p><i>Punime Prishje</i></p> <p><i>Prishje shtresa tarace</i></p> <p><i>Prishje dhe heqje mbulesa, vetrata, dyer, tavane gipsi etj</i></p>	<p>0-20</p> <p>Vlera e parashikuar në preventiv për këtë kategori punimesh është rreth 691,267 lekë</p>
NS 2- A	(Impiante, hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre	<i>Sistemi I mbrojtjes nga zjarri</i>	<p>0-20</p> <p>Vlera e parashikuar në preventiv për këtë kategori punimesh është rreth 77,037 lekë</p>
NS 4- A	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese	<p><i>Punime suvatimi veshje</i></p> <p><i>Punime Dyer Vetrata</i></p> <p><i>Punime Lyerje</i></p> <p><i>Punime Shtresash dhe Hidroizolimi</i></p> <p><i>Punime Mbulesa catie dhe tarrace</i></p>	<p>0-20</p> <p>Vlera e parashikuar në preventiv për këtë kategori punimesh është rreth 1,723,943.2 lekë</p>
NS 8-A	Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri	<p><i>Kategoria e licences perfshin</i></p> <p><i>Prodhimin në kantier dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose</i></p>	<p>0-20</p> <p>Vlera e parashikuar në preventiv për këtë kategori punimesh është rreth 4,944,971.80 lekë</p>

		<i>materiali tjetër Konstruksione metalike Llamarine e valezuar per solete kompozite</i>	
NS 12-A	Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit	<i>Sistemi i Ajrit te Kondicionuar</i>	0-20 Vlera e parashikuar në preventiv për këtë kategori punimesh është rreth 2,694,013.0 lekë
NS 14-A	Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV	<i>Instalimet Elektrike, Sistemi ndricimit Sistemi telefonik, kompjuterik, CCTV etj</i>	0-20 Vlera e parashikuar në preventiv për këtë kategori punimesh është rreth 8,178,443.7 lekë
NS 18-A	Punime topogjeodezike	<i>Punime topografike në matje dhe rlevime</i>	Për referencë vlere është marrë kategoria 0-20

Klasifikimi sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Kontratë pune e vlefshme;
- b) Diplomë.

(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili Operator duhet te përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë për punonjësit e sipërcituar, emrin, profilin e punës dhe rolin që ka pranë shoqërisë.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do të kërkojë ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtëm:

Kontratë pune e vlefshme, diplomë, (Drejtuksi teknik të jetë i siguruar sipas legjislacionit në fuqi).

Argumentimi: *Së pari*, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit”. Gjithashtu, duke qenë se fondi limit për këtë procedurë prokurimi është **32,107,345 (tridhjetë e dy milion e njëqind e shtatë mijë e treqind e dyzet e pesë) lekë**, jemi në kushtet e parashikuara në pikën 2.1 të Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” ku përcaktohet se: “Për vepra me vlerë të plotë, të preventivuar mbi 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimit”.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

2.3.4. Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik

- a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën tre muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi

- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Topograf/ Gjeodet/ Markshajder
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) Inxhinier Mjedisi

b) Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën tre muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Arkitekt
- 1 (nje) Inxhinier Elektronik

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, **“Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”**, operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë për punonjësit e sipërcituar, emrin, profilin e punës dhe rolin që ka pranë shoqërisë.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtëm: Për secilin pjestar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë, Kontratë pune e vlefshme, diplomë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkëndim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 4, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierit të ndërtimit, elektrik, mekanik hidroteknik, topograf, mjedisit është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar në licencë, është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 2.3.4, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin, stafin mbështetës si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP - 2, NP - 3, NS – 1, NS - 4, NS – 8**, është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit të Ndërtimit**. Në këtë vepër parashikohet ndërtimi i strukturave b/arme dhe metalike të mbulesës, si dhe të gjithë punimet e natyrës së rifiniturave të ndërtimit.
- Në këtë vepër parashikohet sistemi i Mbrojtjes ndaj zjarrit etj., referuar kjo pikës **NS - 2**, është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit Hidroteknik**.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NS - 14** është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit Elektrik**. Në këtë vepër një pjesë të rëndësishme e zënë punimet për instalimet elektrike.
- Referuar preventivivit të Punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NS - 18** është e nevojshme prezenca e një **Inxhinieri Gjeodet/Topograf/ Markshajder**, pasi çdo matje që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit kërkon domosdoshmërisht praninë e këtij Inxhinieri.
- Referuar preventivivit të Punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NS – 12**, është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit Mekanik**, pasi kjo vepër parashikon realizimin e sistemeve të kondicionimit dhe ventilimit
- Referuar preventivivit të Punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP- 1, NP-12** është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit të Mjedisit**. Në këtë vepër parashikohen punime të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë dhe në mjedisin përreth duke qenë se vepra realizohet në zonë mjaft të populluar, duke pasur ndikim të drejtpërdrejtë gjatë procesit të prishjes së objektit apo dhe depozitimit dhe evadimit të mbetjeve.

Në kërkesat për personelin e kualifikuar nga AK janë kërkuar disa kategori personeli, të domosdoshëm për të kryer të gjitha shërbimet e nevojshme dhe mbulimin e të gjitha hallkave/etapave të zbatimit të projektit, sipas nivelit të kompetencave profesionale deri në realizimin e plotë të veprës.

Në kërkesat për personelin e kualifikuar janë kërkuar ekspertë të licensuar, sipas profileve të domosdoshme për të mbuluar të gjitha punimet e parashikuara në projekt – zbatimin e parashikuar të realizohet nëpërmjet kësaj kontrate. Një pjesë e këtyre ekspertëve duhet të jenë të përfshirë në licensën e shoqërisë, ndërsa pjesa tjetër si eksperti arkitekt dhe inxhinier elektronik jo domosdoshmërisht të përfshirë në licensën e shoqërisë, por me kontratë pune të vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kësaj kontrate.

-Arkitekt. Projektin parashikon elemente dhe detaje të cilat paraqesin nevojën e një arkitekti. Zërat e punimeve që përfshin ky projekt përmbajnë ndër të tjera punime të rifiniturave, punimet e dymëve, dritareve dhe fasadave etj. Këta zëra punimesh u nështrohen kërkesave të projektit arkitekturor të zbatimit, kërkesave estetike dhe funksionale të specifikuara në këtë projekt. Arkitekti do të shërbejë për

një mbarëvajtje dhe një realizim të detajuar të të gjithë detajeve arkitektonike të parashikuara në projektin e rikonstruksionit të sallës së leksioneve të Paraklinikut.

- **Inxhinier elektronik.** Projekt/preventivi parashikon për sallën e leksioneve realizimin e sistemit telefonik dhe kompjuterik, sisteme të lajmërimit zanor apo CCTV, për të cilën është e domosdoshme prania e inxhinierit elektronik.

2.3.5. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si:

- 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikatë “*Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave*” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës “*Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave*”).
- 1 (një) punonjës me çertifikatë “*Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*” në përputhje me klauzolat e Ligjit nr.10327 datë 18/02/2010 “*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*” dhe VKM nr.312, datë 05.05.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”*”, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës “*Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*”).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, “**Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate**”, operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë për punonjësit e sipërcituar, emrin, profilin e punës dhe rolin që ka pranë shoqërisë.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*”, sipas të cilit: “*Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurtisë e shëndetit në punë.....*”.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si “Përgjegjës për sigurinë

dhe mbrojtjen e shendetit në punë”, nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

Gjithashtu, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen: punime elektrike, saldimi etj të cilat kanë potencial të shkaktojnë aksidenteve me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domozdoshme prania e 1 (një) punonjësi të pajisur me certifikatë “*Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave*”.

- 2.3.6.** Një punësim mesatar i të paktën **55 (pesëdhjetë e pesë)** personave, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi, për periudhën tre muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:
- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën tre muajt e fundit të deklaruar.
 - b. Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën tre muajt e fundit të deklaruar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumentacionit të lartpërmendur

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*” në të cilin thuhet: “*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës*”. Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 55 persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën, ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “*Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre*” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

2.3.7. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme) lëshuar nga institucione publike/private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin profesional në RSH”, i ndryshuar si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën tre muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshte:

- 1 (një) punonjës teknik ndërtimi
- 3 (tre) punonjës murator & suvatues
- 2 (dy) punonjës elektrikistë
- 2 (dy) punonjës specialistë të sistemit të kondicionimit ngrohës-ftohës
- 1 (një) punonjës hidraulik
- 3 (tre) punonjës bojaxhinj
- 1 (një) punonjës gipsi
- 2 (dy) punonjës për punimet e duraluminit
- 1 (një) punonjës marangoz/shtrues parketi
- 2 (dy) punonjës Mekanik
- 3 (tre) punonjës saldimi
- 1 (një) punonjës karpentier
- 1 (një) punonjës hekurkthyes
- 2 (dy) punonjës hidroizolues
- 1 (një) punonjës specialist IT
- 1 (një) automakinist

Për stafin teknik, ofertuesi duhet të paraqesë :

- a. Kontratën individuale të punës të vlefshme;
- b. Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme) lëshuar nga institucione publike/private të akredituara për çertifikimin e punonjësve;
- c. Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën tre muajt e fundit të deklaruar.

Për punonjësit automakinist, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës të vlefshme;
- leje drejtimi, certifikatë e aftësisë profesionale/Patentë Manovrimi nga DPSHTRR.) (Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”. Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialistëve duhet të jenë të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-së.

Në lidhje me 1 (një) punonjës Teknik ndërtimi prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton Autoritetin Kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike. Tekniku i ndërtimit është implementuesi kryesor i rekomandimeve dhe udhëzimeve të inxhinierit të ndërtimit për sa i përket punimeve ndërtimore.

Në lidhje me 3 (tre) punonjës murator & suvatues kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike. Në preventiv parashikohen punime të muraturës dhe suvatime për të cilën është e domosdoshme kualifikimi profesional i kërkuar dhe një numër minimal prej 3 (tre) punonjësish.

Në lidhje me 2 (dy) punonjës elektrikistë kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike. Preventivi parashikon për sallën e leksioneve realizimin e rrjetit elektrik, punimet me rrymat e dobëta, kuadrot elektrike, për të cilën është e domosdoshme kualifikimi profesional i kërkuar dhe një numër minimal prej 2 (dy) punonjësish të specializuar.

Në lidhje me 2 (dy) punonjës specialistë të sistemit të kondicionimit ngrohës-ftohës kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike. Preventivi i objektit në fjalë parashikon instalimin e impianteve mekanike për ventilimin dhe kondicionimin për të cilat nevojitet ky profil profesional.

Në lidhje me 1 (një) punonjës hidraulik kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike. Projekti parashikon instalimet e mbrojtjes nga zjarri njëkohësisht dhe të shkarkimeve të kondesatit të sistemit të ajrit të kondicionuar, për të cilat nevojitet ky profil profesional.

Në lidhje me 3 (tre) punonjës bojxhinj kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike. Projekti parashikon punime lysterje-patinimi, për të cilat nevojitet ky profil profesional.

Në lidhje me 1 (një) punonjës gipsi kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike. Projekti parashikon punimet e ndërtimit të tavaneve/mureve gipsi, për të cilat nevojitet ky profil profesional.

Në lidhje me 2 (dy) punonjës për punimet e duraluminit kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike. Projekti parashikon punimet e veshje fasade me alukobond dhe njëkohesisht punimeve dyer dhe vetrata, për të cilat nevojitet ky profil profesional.

Në lidhje me 1 (një) punonjës marangoz/shtrues parketi kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike. Projekti parashikon instalimet e shtresë dërrasë FM, shtresë parketi laminat si dhe veshje me MDF, për të cilat nevojitet ky profil profesional.

Në lidhje me 2 (dy) punonjës mekanik kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike. Preventivi i objektit në fjalë parashikon ndërtimin e rrjetit shpërndarës të tubacionit të sistemeve të ajrit të kondicionuar dhe ajrimit, për të cilat nevojitet ky profil profesional.

Në lidhje me 3 (tre) punonjës saldimi kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të zërave të punimeve. Projekti parashikon konstruksione metalike me volume rreth 21.4 ton , për të cilat nevojitet ky profil profesional.

Në lidhje me 1 (një) punonjës karpentier kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të zërave të punimeve. Projekti parashikon punime betonarme soleta, për të cilat nevojitet ky profil profesional.

Në lidhje me 1 (një) punonjës hekurkthyes kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të zërave të punimeve. Projekti parashikon punime hekuri dhe armimi, për të cilat nevojitet ky profil profesional.

Në lidhje me 2 (dy) punonjës hidroizolues kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të zërave të punimeve. Projekti parashikon punime tarace perkatesisht shtresa avulluese, termoizolimi apo hidroizolim me 2 flete karton katrama etj, për të cilat nevojitet ky profil profesional.

Në lidhje me 1 (një) punonjës specialist IT kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike. Preventivi parashikon për sallën e leksioneve realizimin e sistemit telefonik dhe kompjuterik, sisteme të lajmërimit zanor apo CCTV, për të cilën është e domosdoshme kualifikimi profesional i kërkuar.

Në lidhje me 1 (një) automakinist kjo kërkesë përputhet për drejtimin e automjeteve për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti: **autovinça**, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak, manovratorëve u jepet dëshmi për **Automakinist**. Në mjetet është kërkuar dhe një autovinç.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë për punonjësit e sipërcituar, emrin, profilin e punës dhe rolin që ka pranë shoqërisë.

Shënim: *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumentacionit të lartpërmendur.*

2.3.8. Operatori/ët ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).
- b) Çertifikatën e sistemit të menaxhimit mjedisor ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).
- c) Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).
- d) Çertifikatën e menaxhimit të energjisë ISO 50001-2011 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, certifikata ISO 50001-2011 do të paraqitet nga Operatori ekonomik që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërave të punimeve elektrike sipas preventivit).

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 50001-2011 është një standard i ri i konceptuar për të asistuar kompanitë në zbatimin e një sistemi të menaxhimit të përshtatshëm për identifikimin dhe minimizimin e konsumit energjetik. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 50001:2011 me qëllim që veprimtaria e ushtruar (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi), të reduktojë kostot energjetike të kompanive, emisionet e gazrave serë (GHG) dhe impaktet e tjera në mjedis. Në Preventivin e punimeve parashikohen zëra elektrik, ku zbatimi i tyre kërkon që Ofertuesi të jetë i pajisur me Certifikatë ISO 50001-2011. Në VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zërat elektrikë të pasrashikuara sipas Preventivit.

Njësia e prokurimit gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 2.5, gërma “a”- “d”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përputhje me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

2.3.9. Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 2 (dy) muaj kalendarike.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3.

2.3.10. Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, nenit 57 të Ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, si dhe fushës III të VKM-së nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit(QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente, për të garantuar realizimin e shërbimeve në përputhje me detyrimet për mbrojtjen e mjedisit.

Përcaktimi i kategorisë së liçensës është bërë duke patur parasysh preventivin dhe volumet, pasi krahas punimeve të prishjeve, përfshihen ndër të tjera edhe transporti i mbetjeve të ngurta urbane, transport i cili referuar kuadrit ligjor në fuqi kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve.

2.3.11. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës 5-10 (dhjetë) ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamioncine me kapacitet 3.5-5ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamioncine me kapacitet 1.5-3.5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me vinç me kapacitet 3.5-7 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 copë	Pronësi ose me qera
Elektrosaldatriçe	2 copë	Pronësi ose me qera
Autovinç	1 copë	Pronësi ose me qera
Vinç me kosh	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere (betoniere kantieri)	2 copë	Pronësi ose me qera
Elektroorgano	2 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator sipërfaqësor	2 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator thellësie	1 copë	Pronësi ose me qera
Elektrotrapano	1 copë	Pronësi ose me qera
Depozitë uji 2,000-5,000 litra	1 copë	Pronësi ose me qera
Skela metalike (formë H) të kompletuara me parapet mbrojtës, shkallë me rrjetë mbrojtëse për punime në fasadë	1,200 m ²	Pronësi ose me qera
Pompë suvatimi	1 copë	Pronësi ose me qera
Vinç ndërtimi me kapacitet 500-1,000 kg. (i montueshem ne kat)	1 copë	Pronësi ose me qera
Makineri për testime për tubat nën presion	1 copë	Pronësi ose me qera

- Kokore minimumi 55 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 10 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë

- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
 - Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
 - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit:- certifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; - certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; leja e transportit që lëshohet nga njësi vendore dhe fotot përkatëse;
 - Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
 - Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve
Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- a) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.
 - b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
 - c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës dëshmon se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.
 - d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Nëpërmjet këtyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistët e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), si dhe hapësirat fizike rreth objektit, mundësive të manovrimit me mjete të renda, urbanizimit për efekt të zhurmave dhe ndotjes etj.

Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave

për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.”, sjellim ne vemendje se:

- Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 8) gjatë fazës së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve, mjeteve/pajisjeve do të jetë kusht s'kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s'kualifikimi.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin e certifikuar në gjuhën shqipe. Dokumentet e lëshuara nga autoritete publike në juridiksione të tjera, dhe dokumentet e vërtetuara nga një noter publik në juridiksione të tjera duhet të legalizohen sipas Konventës së Hagës për Vulën Apostile, të datës 05.10.1961.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar për çdo zë punimi të kësaj vepre sipas preventivit dhe janë të hartuara nga projektuesi dhe të miratuara me Vendimin nr.10, datë 31.05.2022 nga Universiteti i Mjeksisë, Tiranë.

Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me pjesën teknike janë hartuar nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Rikonstruksion Salla e Leksioneve tek Godina e Paraklinikut”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim Znj. Ilva Ymeraj.

Njësia e Prokurimit: